



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe Plotësim ndryshimit të UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, bazuar në Kodin e Punës nr. 804 të datës 28.01.2025 të KEK sha, si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Termocentralit Kosova A, UD Krye shefi Ekzekutiv i KEK-ut më 16.06.2025 autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore që të publikojë konkursin për pozitën e mëposhtme:

KONKURS

I. Titulli i pozitës: Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë

Institucioni: Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës: 09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës: Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimi të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-ut
Titulli i mbikëqyrësit: I raporton Menaxherit të Njesisë për Implementimin e Projekteve.
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga: 971.00 Euro
Procedura e aplikimit: I jashtëm
Numri i kërkuar: 1
Vendi i punës: Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës bënë Menaxhimin e projekteve në të gjitha fazat e tij (përgatitja e specifikimeve teknike për tender, vlerësimi i ofertave, menaxhimi i kontratave, dhe mbikëqyrja e tyre) Mbështetja inxhinierie për shërbimin e mirëmbajtjes makinerike, elektrike apo prodhimit sipas kërkesave të paraqitura. I raporton Menaxherit të NJIP, Menaxherit të remonteve (nëse është pjesë e remontit të blloqeve) dhe/ose Menaxherit të projektit nëse është anëtar ekipit të menaxhimit të një projekti me të ndërlikuar. Përgatitja e specifikimeve teknike duke i ofruar të gjitha materialet e nevojshme (skicat, vizatimet, të dhënat teknike, etj) për prokurim të suksesshëm:

Pjesëmarrje në vlerësim të ofertave/tenderëve. Menaxhimin e projekteve gjatë fazës së implementimit duke i respektuar të gjitha rregullat e kontratave (mbajtjen e takimeve me kontraktor, njoftimin për vonesat eventuale, raportimin e ecurisë dhe mbarëvajtjes së punës të kontratave). Pjesëmarrje në takimet me kontraktor dhe takimet e remonteve të blloqeve duke i kryer të gjitha obligimet që i parashtrihen. Të kontribuoj në përgatitjen e strategjisë afatmesme për planifikimin e projekteve të nevojshme për rritjen e efikasitetit, besueshmërisë dhe produktivitetit të TCA. Detyra, caqe dhe projekte tjera që i caktohen kohë pas kohe nga udhëheqësit e tij

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimtarisë (master ose fakultet 5 vjeçar)
Trajnime në menaxhimin e projekteve (kurse të shkurtra të certifikuara). I aftë në aplikimin e MS Projektit, MS Office. Aftësi të mira të komunikimit në gjuhën angleze. Aftësi profesionale dhe organizative. Aftësi të punës nën stres dhe i gatshëm për bashkëpunim me kolegët tjerë dhe palët të treta. Aftësi të shkëlqyeshme vendimmarrëse përmes peshimit të rreziqeve, konsiderimit të opsioneve dhe zgjidhjeve të duhura

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese: Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: "Ngarko Aplikacionin e plotësuar" vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (apo masterit)** e ngarkoni në vegëzen "Ngarko dëshmitë e kualifikimit". Dhe dëshminë për trajnime. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

II. Titulli i pozitës: Inxhinier i kryerjes i makinerisë

Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plot ndrysh. të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-ut
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton inxhinierit përgjegjës të sektorit përkatës (për sistemet në kaldaje të avullit ose salle të makinave ose objektet e jashtëm apo serviseve të Departamentit të Mirëmbajtjes Mekanike)
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	869.00 Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	17 vende
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Organizon mirëmbajtjen e pajisjeve mekanike në sistemin përkatës ku punon

Lëshon urdhëresat e punës me përshkrim detal të fazave të punës, veglat, kryerësit dhe kualifikimet e nevojshme, përshkrimin sa më të saktë dhe teknikisht në nivel ashtu që të jete sa më i përshtatshëm për kryerjen e punëve nga kryerja duke respektuar normat teknike. Përgatit udhëzimet e preventivave me përshkrime të sakta tekniko teknologjike dhe bënë përmirësimin e tyre në baze të përvojës dhe nevojave të pajisjeve. Formon dokumentacionin teknik ku përfshihen: dokumentacioni i prodhuesit, preventivat, historikun e pajisjeve, udhëzimet për kryerjen e punëve, udhëzimet për eksploatim të pajisjeve dhe sipas nevojës e plotëson me të arriturat teknike të kohës. Jep propozime për përmirësime të nevojshme në sistemin përkatës në baze të përcjelljes së punës së pajisjeve dhe zgjidhjen e fyteve të ngushta. Kontrollon sistemin dhe ruajtjen e dokumentacionit tekniko teknologjik. Nga inxhinieri i kryerjes, gjatë kryerjes së punës sipas UP (Urdhëresa të Punës) dhe preventivave të lëshuara, kërkon respektimin rigoroz të udhëzimeve tekniko teknologjike si dhe kryerjen e tyre me afat dhe kualitet. Përgatit të gjitha planet e aktiviteteve për remonte/revizione dhe ndalje të njësive prodhuese (A3, A4 dhe A5)

Bënë porositjen e pjesëve rezervë si dhe përcjell sasinë e tyre në baze të minimumit dhe maksimumit të planifikuar, duke pasqyruar shfrytëzimin sa më racional të tyre. Kontrollon eksploatimin e pajisjeve dhe jep vërejtje dhe sugjerime për eksploatimin e tyre. Është i obliguar të përcjell të arriturat tekniko teknologjike dhe të implementoj ato në sistemin e mirëmbajtjes bashkëkohore. Ndiemon inxhinierin e kryerjes për zgjedhjen e problemeve të paraqitura

Kontrollon grupet e punës të formuara sipas UP të lëshuara nga ai dhe përcjell punët e tyre. Kontrollon respektimin e orarit të punës si dhe disiplinën e personelit të përfshirë në kryerjen e punëve në sistemin e tij dhe është përgjegjës për të. Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë. Zbaton urdhrat për punë dhe organizim të lëshuara nga kryeinxhinieri i sistemit përkatës. Të përgjigjet çdo kohe thirrjes për intervenim dhe të vazhdojë punën sipas nevojës.

Kryen edhe punë tjera me urdhrin e kryeinxhinierit apo Menaxherit të Mirëmbajtjes Mekanike

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Fakulteti i inxhinierisë mekanike niveli bachelor(drejtimi: termo energjetikë, konstruksione, prodhimtaria, inxhinieria industriale, energjia e ripërtrishme)

Aftësi profesionale dhe organizative. Aftësi që të arrij afate kohore

Marrjen e vendimeve dhe aftësi për punë ekipore

Njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegjëza: **"Ngarko Aplikacionin e plotësuar"** vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (bachelorit) e ngarkoni në vegezen "Ngarko dëshmitë e kualifikimit"**. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

III. Titulli i pozitës: Inxhinier i përgjegjës i makinerisë ne Departamentin e Mirëmbajtës Mekanike – Departamenti i inxhinëringut

Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plot ndrysh. të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-ut
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Kryeinxhinierit për sistemet ne kaldaje te avullit ose salle te makinave ose objektet jashtëm apo serviseve te Departamentit Mirëmbajtës Mekanike. Ose i raporton kryeinxhinierit te Diagnostikimit ose Kryeinxhinierit të Mbrojtjes së ambientit
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	971.00 Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	11 vende
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Organizon mirëmbajtjen e pajisjeve mekanike ne sistemin përkatës ku punon

Lëshon urdhëresat e punës me përshkrim detal te fazave te punës, veglat, kryerësit dhe kualifikimet e nevojshme, përshkrimin sa me te saktë dhe teknikisht ne nivel ashtu që te jete sa me i përshtatshëm për kryerjen e punëve nga kryerja duke respektuar normat teknike. Të merret me çështjet e vibrimeve dhe ballansimin e rotorëve të makinat me ngasje rotative. Të kontrolloj dhe të bëj centrimin e makinave horizontale dhe vertikale duke përdorur pajisjet e avancuara laserike për centrim.

Të realizoj inxhizime me infrared kamerë në pajisjet elektrike dhe mekanike duke identifikuar pikat e nxehta në lidhje elektrike, mungesën e izolimit në pjesët mekanike etj.

Përgatit udhëzimet e preventivave me përshkrime te sakta tekniko teknologjike dhe bënë përmirësimin e tyre ne baze te përvojës dhe nevojave te pajisjeve. Formon dokumentacionin teknik ku përfshihen: dokumentacioni i prodhuesit, preventivat, historikun e pajisjeve, udhëzimet për kryerjen e punëve, udhëzimet për eksploatim te pajisjeve dhe sipas nevojës e plotëson me te arriturat teknike te kohës. Jep propozime për përmirësime te nevojshme ne sistemin përkatës ne baze te përcjelljes se punës se pajisjeve dhe zgjidhjen e fyteve te ngushta. Kontrollon sistemimin dhe ruajtjen e dokumentacionit tekniko teknologjik.

Nga inxhinieri i kryerjes, gjate kryerjes se punës sipas UP (Urdhëresa të Punës) dhe preventivave të lëshuara, kërkon respektimin rigoroz te udhëzimeve tekniko teknologjike si dhe kryerjen e tyre me afat dhe kualitet. Përgatit te gjitha planet e aktiviteteve për remonte/revizione dhe ndalje te njërive prodhuese (A3, A4 dhe A5) Ben porosinë e pjesëve rezervë si dhe përcjell sasinë e tyre ne baze te minimumit dhe maksimumit te planifikuar, duke pas parasysh shfrytëzimin sa me racional te tyre. Kontrollon eksploatimin e pajisjeve dhe jep vërejtje dhe sugjerime për eksploatimin e tyre. Është i obliguar te përcjell te arriturat tekniko teknologjike dhe ti implementoi ato ne sistemin e mirëmbajtjes bashkëkohore.

Ndihmon inxhinierin e kryerjes për zgjedhjen e problemeve te paraqitura

Kontrollon grupet e punës te formuara sipas UP te lëshuara nga ai dhe përcjell punët e tyre.

Kontrollon respektimin e orarit te punës si dhe disiplinën e personelit te përfshirë ne kryerjen e punëve ne sistemin e tij dhe është përgjegjës për te. Zbaton te gjitha rregullat e sigurisë. Zbaton urdhrat për punë dhe organizim te lëshuara nga kryeinxhinieri i sistemit përkatës. Ti përgjigjet çdo kohe thirrjes për intervenim dhe te vazhdoj punën sipas nevojës.

Kryen edhe pune tjera me urdhrin e kryeinxhinierit apo Menaxherit te Mirëmbajtjes Mekanike

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Fakulteti i inxhinierisë mekanike niveli master ose inxhinier i diplomuar (studimet 5 vjeçare)(drejtimi: termoenergjetike, konstruksione, prodhimtaria, inxhinieria industriale, energjia e ripërtërisheme)

Aftësi profesionale dhe organizative

Aftësi qe te arrij afate kohore

Marrjen e vendimeve dhe aftësi për pune ekipore

Njohuri ne përdorimin e kompjuterit.

Dokumentet qe duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: “Ngarko Aplikacionin e plotësuar” vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (masterit) e ngarkoni ne vegezen “Ngarko dëshmitë e kualifikimit”. Si dhe përvojën e punës e dëshmonii (perparesi)**
Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin qe dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

IV. Titulli i pozitës: Inxhinier kryerjes në Departamentin e Elektrikes dhe MRRK

Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024,plot ndrysh. të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-u
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton inxhinierit përgjegjës
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	869 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	7 vende
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës Kryen detyrat dhe organizon : përditshmërinë e punëve si dhe riparimin e stabilimenteve gjatë ndaljeve të shkurta. Përgjigjet për realizimin e detyrave. Për punët e pakryera. Përgjigjet për realizimin e detyrave për grupin gjegjëse. Jep raportin përkatës për kryerjen e punëve. Merr materialin e nevojshëm për stabilitet të pajisjeve dhe revizion.

Përgjigjet për realizimin e detyrave për grupin gjegjëse. Zbaton urdhëresat e punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë ne vijën organizative. Duhet te bashkëpunoj me koleget nga shërbimet adekuat te mirëmbajtjes për probleme te cilat janë te përbashkëta për mbarëvajtjen e punëve ne sistemin e Elektrikes.

Autorizimet ;Është i autorizuar te kërkojë te gjitha kompensimet te përcaktuara ne kontratën e tij/saj ,Kërkojnë ndihme nga stafi udhëheqës apo edhe nga koleget tjerë për zgjedhjen e problemeve specifike

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Duhet te ketë përgatitje shkollore: Bachollor I energjetikes.

Përvoja e pune përparësi ne punësim.

Aftësi profesionale dhe organizative

Aftësinë që të arrijë afatet kohore.

Marrjen e vendimeve dhe aftësi për punë ekipore.

Njohuri ne përdorimin e kompjuterit.

Njohuri e gjuhës angleze e dëshirueshme.

Dokumentet qe duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”** vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (bachelorit) e ngarkoni ne vegezen “Ngarko dëshmitë e kualifikimit”**.dhe Përvoja e punes e deshmoni me deshmi (perpares)

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin qe dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

V. Titulli i pozitës: Inxhinier kryerjes ne Departamentin e Mirëmbajtës elektrike dhe MRRK

Institucioni: Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës: 09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës: Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024,plot ndrysh. të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-u
Titulli i mbikëqyrësit: I raporton Drejtpërdrejt i raporton Inxhinierit përgjegjës, krye inxhinierit te shërbimit të MRRK dhe Menaxherit te Departamentit
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga: 869 euro
Procedura e aplikimit: I jashtëm
Numri i kërkuar: 3
Vendi i punës: Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës ekzekuton të gjitha punët, në pajisjet e MRRK në Bil.(A3...A5). I organizon dhe i udhëheq punët në bazë të udhëzimeve teknologjike, prospekteve dhe dokumentacioneve të përgatitura si dhe udhëzimeve me gojë që i merr nga teknologu përgjegjës .Bashkëpunon gjatë përpilimit të planeve për remonte dhe revizione. Ne bazë të detyrave të marruara formon grupe punëtorësh bën koordinimin e punëve në mes grupeve, duke ju dhënë udhëzime shtese, prijësit të grupit dhe punëtorëve për kryerjen e punëve. Merr pjesë në kryerjen e ca urdhëresave të caktuara të punës. Kujdeset për kualitetin e punëve të kryera. Ndërmerr masa të duhura me qëllim të sigurisë sa më të madhe gjatë kryerjes së punëve. Kujdesohet që pajisjet, instrumentet në MRRK. Të shfrytëzohen në mënyrë sa më të drejtë. Evidenton kohën e kaluar të punëtorëve në kryerje sipas urdhëresave të punës ,gjithashtu mban evidencë për kohën e kaluar gjate kryerjes se punëve. Mbikëqyrë punën e pajisjeve me rendësi të veçanta dhe ndërmerr masa përkatëse për eliminimin e prishjeve eventuale. Kujdeset për mbrojtjen e punëtorit në vende të punës, verifikon punëtorët se a i kanë mjetet për mbrojtjen në punë gjatë kryerjes së punëve dhe a është bërë mbrojtja dhe sigurimi sipas normave ne pajisjet te cila mirëmbahet. Kontrollon vendin e punës, pas kryerjes së punëve , dhe verifikon qe pajisja e aftësuar a është pru në gjendje të rregullt sipas normave dhe standardeve qe kërkohej. Mbanë evidencën për kohën e punës së rregullt dhe punës së vazhduar për pajisjen qe duhet te aftësohet sipas kërkesës se bërë.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Duhet te ketë përgatitje shkollore: Bacholler i Elektronikes, Mekatronikes ose Automatikes
Përvojë e pune përparësi ne punësim.
Aftësi profesionale dhe organizative.
Aftësinë që të arrijë afatet kohore.
Marrjen e vendimeve dhe aftësi për punë ekipore .
Njohuri ne përdorimin e kompjuterit
Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.

Dokumentet qe duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:

Gjate aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:
Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”** vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.
Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (bachelorit) e ngarkoni ne vegezen “Ngarko dëshmitë e kualifikimit”.**
Si dhe përvojën e punës e dëshmoni me Kontratë pune, Vërtetim apo trust.
Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin qe dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

VI. Titulli i pozitës: Inxhinier i makinerisë i kryerjes ne Departamentin e Mirëmbajtës elektrike dhe MRRK

Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024,plot ndrysh. të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-u
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Drejtpërdrejt Inxhinierit përgjegjës, krye inxhinierit te shërbimit të MRRK
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	869 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	2
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës kryen i përcjell dhe jep këshilla ne të gjitha punët në MRRK Bll.(A1...A5) dhe O.J. për Mekanike hidraulike dhe pneumatike. Gjithashtu kujdeset për ruajtjen e dokumentacionit dhe prospekteve (udhëzimeve). I organizon dhe i udhëheq punët në bazë të udhëzimeve teknologjike, prospekteve dhe dokumentacioneve të përgatitura si dhe udhëzimeve me gojë që i merr nga teknologu përgjegjës .Bashkëpunon gjatë përpilimit të planeve për remonte dhe revizione. Ne bazë të detyrave të marruara formon grupe punëtoresh bën koordinimin e punëve në mes grupeve, duke ju dhënë udhëzime shtese, prijësit të grupit dhe punëtoresh për kryerjen e punëve. Merr pjesë në kryerjen e ca urdhëresave të caktuara të punës. Kujdeset për kualitetin e punëve të kryera. Ndërmerr masa të duhura me qëllim të sigurisë sa më të madhe gjatë kryerjes së punëve. Kujdesohet që pajisjet, instrumentet në MRRK. të shfrytëzohen në mënyrë sa më të drejtë. Evidenton kohën e kaluar të punëtoresh në kryerje sipas urdhëresave të punës ,gjithashtu mban evidencë për kohën e kaluar gjate kryerjes se punëve. .Mbikëqyrë punën e pajisjeve me rendësi të veçantë dhe ndërmerr masa përkatëse për eliminimin e prishjeve eventuale. Kujdeset për mbrojtjen e punëtorit në vendet të punës, verifikon punëtorët se a i kanë mjetet për mbrojtjen në punë gjatë kryerjes së punëve dhe a është bërë mbrojtja dhe siguri sipas normave ne pajisjet te cila mirëmbahet.

Kontrollon vendin e punës, pas kryerjes së punëve , dhe verifikon që pajisja e aftësuar a është prurë në gjendje të rregullt sipas normave dhe standardeve që kërkojnë. Mban evidencën për kohën e punës së rregullt dhe punës së vazhduar për pajisjen që duhet të aftësohet sipas kërkesës së bërë.

Punon edhe punë tjera sipas kërkesës së inxhinierit përgjegjës.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Duhet te ketë përgatitje shkollore: Bacholler I Makinerisë.

Përvojë e punës përparësi për pune.

Aftësi profesionale dhe organizative.

Aftësinë që të arrijë afatet kohore.

Marrjen e vendimeve dhe aftësi për punë ekipore .

Njohuri ne përdorimin e kompjuterit

Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.

Dokumentet që duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”** vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (bachelorit) e ngarkoni ne vegezen “Ngarko dëshmitë e kualifikimit”. Si dhe përvojën e punës e dëshmoni me Kontratë pune, Vërtetim apo trust (përparësi)**

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

VII. Titulli i pozitës: Inxhinier përgjegjës në Departamentin e Mirëmbajtës elektrike dhe MRRK

Institucioni: Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës: 09-16.06.2025
Tipi Akt Emërimit të punës: Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plot ndrysh. të UA03/2025 dhe Kodit të Punës së KEK-u
Titulli i mbikëqyrësit: I raporton Drejtpërdrejt Kryeinxhinierit dhe Menaxherit Mirëmbajtjes Elektrike dhe MRRK-ës por sipas nevojës edhe udhëheqëseve të tjerë si dhe drejtorit të TCA-se.
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga: 971 euro
Procedura e aplikimit: I jashtëm
Numri i kërkuar: 3
Vendi i punës: Korporata Energjetike e Kosovës (Termocentrali Kosova A-Obiliq)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës Planifikon detyrat dhe organizon : përditshmërinë e punëve si dhe riparimin e stabilimenteve gjatë ndaljeve të shkurta. Jep udhëzime përkatëse për kryerjen e punëve. Planifikon materialin e nevojshëm për stabilitet të pajisjeve dhe revizion. Përgjigjet për realizimin e detyrave për grupin gjegjëse. Për kualitetin e punëve dhe sigurinë e punëtorëve. Për punët e pakryera .Për evidencën e sakët të orëve për paga.

Duhet të bashkëpunoj me koleget nga shërbimet adekuate të mirëmbajtjes për probleme të cilat janë të përbashkëta për mbarëvajtjen e punëve në sistemin e Elektrikes.

Zbaton urdhëresat e punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë në vijën organizative

Detyra tjera sipas nevojës që janë të në harmoni me aftësitë profesionale siç është puna në komisione profesionale e tjera.

Është i autorizuar të kërkojë të gjitha kompensimet të përcaktuara në kontratën e tij/saj

Të kërkojë ndihmë nga stafi udhëheqës apo edhe nga koleget tjerë për zgjedhjen e problemeve specifike.

Drejtpërdrejt i raporton Kryeinxhinierit dhe Menaxherit Mirëmbajtjes Elektrike dhe MRRK-ës por sipas nevojës edhe udhëheqëseve të tjerë si dhe drejtorit të TCA-se. Bashkëpunon me të gjithë inxhinieret përgjegjës , inxhinieret e kryerjes, prijësit e ekipeve dhe tekniket e Elektrikes.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet:

Duhet të ketë Përgatitje Superiore Profesionale nga lëmia e Energjetikes Master apo Inxhinier i diplomuari energjetikes ose Bachelor i energjetikes me tre (3) vjet përvojë pune në lëmin përkatës.

Aftësi profesionale dhe organizative.

Aftësinë që të arrijë afatet kohore.

Marrjen e vendimeve dhe aftësi për punë ekipore.

Njohuri në përdorimin e kompjuterit

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”** vetëm formën tonë që gjendet në ueb faqen e KEK-ut.

Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit (bachelorit) e ngarkoni në vegezen “Ngarko dëshmitë e kualifikimit”.** **Si dhe përvojën e punës e dëshmoni me Kontratë pune, Vërtetim apo trust (obilgative)**

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, Por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024, plotësim ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e punës nr. 804 te datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Jetë përshkrimi (CV) deri dhjetë(10) pikë
Testi me shkrim deri shtatëdhjetë(70) pike
Intervista vlerësohet deri njëzetë (20) pikë

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (intervistës) dhe vlerësimit të CV-së, përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/I-044.

Për më shumë informata për pozitën e lartpërmendur vizitoni ueb-faqen: www.kek-energy.com, ikona 'Shpallje' dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që aplikoni.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, ne cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen.**

Asnjë aplikacioni dhe dokumentacion i dorëzuar pas afatit, nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Ankesave, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe në afatin prej 3 (tri) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës për ato pozita pune që ka mungese te theksuar të punëtorëve.

Kalendari i përafërt: brenda 25 ditësh vlerësimi Testi me shkrim. Njoftimi brenda 3 ditësh , Intervista me goje dhe vlerësimi i CV nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2024 dhe në bazë të Kodit të Punës nr. 804 te datës 28.01.2025 kryhet brenda 15-30 dite(mvarsiht nga numri i kandidateve), dhe njoftohen kandidatet brenda 10 dite. Nënshkrimi i kontratës me kandidatet fitues mund te behet pasi te përfundon afati i ankesave i fazës se tret(pas njoftimit me piket e përfundimtare te vlerësimit te testit me shkrim dhe intervistës me goje e CV)

Data e aplikimit deri më 01.07.2025 ora 24:00
Prishtinë, 16.06.2025

Divizioni i Burimeve Njerëzore

për [Signature]

